

Komuna e Malishevës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Malishevës udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetari aktual i kësaj komune është Isni Kilaj. Ai këtë funksion e ushtron që nga viti 2007.
2. Në Komunën e Malishevës zhvillojnë aktivitet afërsisht 1.300 biznese private, me rreth 1.200 punëtorë. Shumica (90%) prej këtyre bizneseve janë ndërmarrje të vogla, me numër të të punësuarve prej 1-9 punëtorë. Veprimtaria e tyre është kryesisht tregtare (afro 46%), prodhuese (18%), transportuese (14 %), zejtare (10%), hoteliere (5%), shërbyese (2.2%) dhe të tjera të ndryshme (4%). Gjatë një viti në këtë komunë regjistroheshin afërsisht 200 biznese të reja.¹
3. Komuna e Malishevës nga regjistrimi i fundit i popullsisë ka dalë komuna e vetme në Kosovë e cila ka më shumë femra se meshkuj. Kjo komunë ka 54.613 banorë.²
4. Komuna e Malishevës ka gjithsej 11 Drejtori komunale. Pozita e nënkryetarit udhëhiqet nga partia e njëjtë e kryetarit, PDK. Kjo parti në këtë komunë nuk ka hyrë zyrtarisht me asnjë subjekt politik në ndonjë koalicion pas zgjedhor.
5. Të dhënat e UNDP të dala nga matjet e opinionit publik të përmbledhura në raportin “Mozaiku i Kosovës 2012” tregojnë 64% e banorëve të Malishevës besojnë se problemet e tyre lokale mund t'i zgjedhë komuna, ndërsa 24% janë shprehur se për problemet e tyre në lagjen ku banojnë ata mund t'i zgjedhë vetëm Qeveria.³
6. Vlerësimet e bëra nga Instituti GAP në fund të vitit 2009 tregojnë se problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë mungesa e

¹ Komuna e Malishevës. Raporti vjetor I Kryetarit të Komunës për periudhën janar – dhjetor 2012. Fq 20. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/getattachment/9ca27445-b1ff-4cc9-8875-08a2f73ec405/Raporti-i-punes-se-kryetarit-dhe-qeverise-komunale.aspx>

² Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 94. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

kanalizimeve dhe prezenca e ujërave të zeza, mungesa e ujit të pijes, zonat endemike nga prezenca e rriqrave të infektuara si dhe gjendja e keqe e objekteve shkollore.⁴

Problemet kryesore të Komunës së Malishevës.

- 1. Pickimi i rriqrave.** Gjatë këtij viti nëntë persona kanë vdekur në Komunën e Malishevës nga pickimi i rriqrave.⁵ Në katër vitet e fundit numri i të vdekurve në Malishevë nga pickimi i rriqrave kalon shifrën e 20 personave. Malisheva është shpallë nga Instituti i Shëndetit Publik si zonë endemike e shkallës së lartë nga pickimi i rriqrave të cilat shkaktojnë infektimin me sëmundjen e etheve hemorragjike “Crime Congo”. Rreth 39 zona endemike, në përjashtim të Vargmaleve të Berishës, konsiderohen zona të përhapjes së rriqrave. Banorët e këtyre zonave kritikojnë autoritetet lokale dhe ato qendrore për neglizhencë në marrjen e masave në parandalimin e përhapjes së rriqrave.⁶ Rriqrat vlerësohen të fillojnë të jenë aktive në fillim të periudhës së muajit prill. Autoritetet lokale dhe ato qendrore, masat kundër rriqrave i kanë ndërmarr në fund të muajit gusht.⁷
- 2. Mungesa e ujit të pijes.** Malisheva dhe fshatrat përreth përballen me mungesë të ujit të pijes. Pjesa dërmuese e fshatrave kanë këtë problem dhe mundohen të bëjnë zgjidhje individuale, duke hapur puse. Fshati Dragobil, i cili është fshati më i madh në Malishevë, që ka rreth 5 mijë banorë, përballen me këtë problem. Gjithashtu, edhe në fshatrat tjerë ndihet mungesa e ujit të pijes, si në Vërmicë, Bubavec, Mleqan, Kijevë, Balincë, etj. Mungesa e ujit ndihet edhe në disa shkolla të fshatrave, ku njejt sanitare edhe pse janë të instaluar ato nuk janë në funksion dhe kjo po ndikon negativisht te mirëmbajtja e ambientit shkollor. Në këtë gjendje është shkolla fillore “Visar Krasniqi”, ku nxënësit për nevojat e tyre fiziologjike duhet të dalin jashtë objektit shkollor. Përveç kësaj, në fshatrat si, Maxharë, Dragobil, Carralluk, është dërguar gypi kryesor i ujësjellësit, por nuk është bërë shpërndarja e gypave deri në afërsi të shtëpive. Lidhja në gyp nga banorët në formë private ka dal të jetë e kushtueshme duke pamundësuar kësisoj lidhjen e tyre. Sipas të dhënave të UNDP-së, vetëm 26% e familjeve në Malisheve janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit publik, përderisa pjesa tjetër ujin e sigurojnë nga burimet

⁴ Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Malishevës. 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/39288_Malisheva-raporti%20komunal.pdf

⁵ Lajmet Shqip. Burim Agjencia “Kosova Press”. 2 Gusht 2013. Burimi: <http://www.lajmeshqip.com/kombetare/viktima-e-nente-nga-rriqrat>

⁶ Gazeta “Zëri”. Autor, Valmira Halimi. 09.08.2013. Rriqrat pushtojnë Malishevën. Burimi: <http://www.zeri.info/artikulli/11671/rriqrat-pushtojne-malisheven>

⁷ Portali “Indeksonline”. 15.08.2013. Malisheva fillon spërkatja kundër rriqrave. Burimi: <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=67693>

alternative si hapjen e puseve. Edhe raporti i UNDP-së nxjerr në pah problemin që kanë banorët e Malishevës me furnizim me ujë të pijes, përkatësisht reduktimet e gjata dhe të shpeshta. Kësisoj, tridhjetë e nëntë përqind të familjeve të lidhura me ujësjellësin publik (në krahasim me mesataren e familjeve kosovare 42%) pohojnë se kanë furnizim të pakufizuar me ujë. Njëzet e tetë përqind kanë ndërprerje me kohëzgjatje nga 1 deri në 4 orë në ditë, 4% kanë ndërprerje të furnizimit nga 5 deri në 10 orë në ditë, kurse për 22% të tyre, ndërprerjet ditore të furnizimit me ujë zgjasin më shumë se 11 orë.⁸

3. Mungesa e kanalizimit në disa vendbanime. Ky problem është më i theksuar në fshatrat e Malishevës, ndërsa në qytet për afërsisht për 90% kanalizimi është i përfunduar, në përjashtim të Lagjes së Veselajve që kanë mungesë të kanalizimit. Komuna e Malishevës gjatë katër viteve të fundit i ka kushtuar rëndësi zgjerimit dhe instalimit të rrjetit të kanalizimit në zonat urbane, ngase pjesa më e madhe e këtyre zonave nuk ka pasur rrjet të kanalizimit. Kjo ka bërë që investimet në fshatrat e kësaj ane për rregullimin e kanalizimit të jenë të kufizuara. Kësisoj, pa kanalizim janë fshatrat Pagarushë, Mirushë, Panorc, Turjake, Ngucat, Temeqin, etj. Banorët e këtyre fshatrave detyrohen si alternativë për derdhjen e ujërave të zeza të hapin gropa septike. Në hulumtimin e opinionit nga USAID/DEMI, tregohet se vetëm 48.5% e qytetarëve të kësaj ane janë të kënaqur me rrjetin e kanalizimit në vendbanimin e tyre.⁹

4. Mungesa e ndriçimit publik. Aktualisht vetëm rruga “Adem Jashari” dhe “Orllat Rahoveci” kanë ndriçim publik në Malishevë, ndërsa rrugët tjera nuk janë të përfshira në sistemin e ndriçimit publik. Madje problem për mungesë të ndriçimit publik, e sidomos gjatë dimrit, ka rruga “Hamdi Berisha” e cila e lidh qendrën komunale me lagjen “Mirdita”, ku ka frekuentim të madh të numrit të nxënësve. Në asnjë fshat apo lagje periferike të Malishevës nuk ka ndriçim publik. Në hulumtimin e opinionit nga USAID/DEMI, tregohet se 53% e qytetarëve në këtë komunë ndihen të pakënaqur me prezencën e ndriçimit publik.¹⁰

5. Ekzistimi i deponive ilegale të mbeturinave. Mbeturinat janë një problem tjetër në këtë komunë. Një numër fshatrash nuk janë nën menaxhimin për grumbullim të mbeturinave. Në këtë mënyrë njerëzit

⁸ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 93. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁹ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 21. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

¹⁰ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 41. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

i hedhin mbeturinat në vende jo adekuate dhe në këtë mënyrë gradualisht këto vende po shndërrohen në deponi ilegale. Një deponi ilegale e mbeturinave gjendet në hyrje të fshatit Carallukë. Gjithashtu, në hyrje të fshatit Vërmicë dhe Llazicë.¹¹ Sipas të dhënave të UNDP-së, të përmbledhura në raportin “Mozaiku i Kosovës”, 34% e banorëve në Malishevë e vlerësojnë shumë të ndotur qytetin e tyre, përderisa 22% e vlerësojnë shumë të ndotur lagjen dhe vendbanimin e tyre.¹²

6. Mungesa e çerdhes publike. Aktualisht, Komuna e Malishevës nuk ka asnjë çerdhe publike. Kjo konsiderohet problem i madh në këtë komunë. Ngase prindërit nuk kane se ku t'i dërgojnë fëmijët e tyre për përgatitje parashkollore.

7. Rruga e dëmtuar në Lagjen e Kodralive dhe mungesa e sinjalizimit. Në fshatin Kërvasari, përkatësisht në Lagjen e Kodralive ekziston rruga me një gjatësi rreth 1.5 km e cila të shpie deri në qendër të fshatit, por që është shumë e dëmtuar, ku veturat nuk mund të kalojnë. Për të shkuar në qendër, njerëzit duhet të ndjekin një rrugë tjetër rreth 20 km, e cila i bie rrotull. Gjendje e keqe qëndron në vendosjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në qytet. Vetëm pjesa e qendrës së qytetit posedon sinjalizim të tillë, kurse pjesët periferike dhe fshatrat nuk kanë sinjalizim. Përveç kësaj, problem vlerësohet edhe mungesa e emërtimit të rrugëve dhe vendbanimeve të tjera. Në hulumtimin e opinionit nga USAID/DEMI, 31% janë shprehur të pakënaqur me gjendjen e rrugëve, përderisa 55% janë deklaruar të pakënaqur me gjendjen e qytetit të tyre për sa i takon sinjalizimit vertikal dhe horizontal.¹³

Gjërat pozitive që duhet ruajtur

1. Ujëvara e Mirushës. Konsiderohet si një ndër pasuritë natyrore më të mëdha në Kosovë. Qytetarët dëshirojnë të shohin investime komunale apo qendrore të cilat mundësojnë ndriçim publik afër

¹¹ Koha Ditore. 03.09.2013. Autor, Rexhep Krasniqi. Deponitë ilegale të mbeturinave vërshojnë Malishevën. Burimi: <http://www.koha.net/?page=1,31,113774>

¹² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 93. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

¹³ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 26. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

urës në afërsi të ujëvarës, vendosjen e shenjave orientuese, hapjen e shtigjeve për biçikleta, etj.


2. Pishina e Banjës. Në fshatin Banjë ekziston pishina e cila është pronë komunale. Karakteristikë e kësaj pishine është uji që konsiderohet shërues. Nga Komuna kërkohet zgjerim i hapësirës së pishinës, rregullim i ndriçimit, vendosje e ulëseve si dhe zhvillimi i një kampanje informuese në lidhje me këtë banjë.

Trendet Buxhetore në Komunën e Malishevës

Komuna e Malishevës i ka planifikuar buxhet prej 10.2 milion euro në vitin 2013. Komuna ka pasur një ngritje konstante të buxhetit në tri vitet e fundit, ndërsa krahasuar me vitin 2010 buxheti i kësaj komune është ngritur për 2.5 milion euro (33%). Të hyrat vetanake në vitin 2012 kanë qenë 844 mijë euro dhe kanë shënuar ngritje prej 195 mijë euro krahasuar me vitin 2010. Raporti i Auditorit¹⁴ ka rekomanduar që komuna të krijojë një sistem automatik të faturimit për të gjitha llojet e taksave dhe të ndërmerren masat për rritjen e inkasimit nga taksat e ndryshme.

Figura 1. Buxheti i Komunës së Malishevës 2013


¹⁴ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Malishevës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/Malisheve_Report_ALB_25613_332291.pdf



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?malisheve/2013>

Përveç rritjes së pagave në vitin 2011 dhe një ngritje të lehtë që planifikohet të ndodh tek shpenzimet kapitale në vitin 2013, kategoritë tjera të shpenzimeve në këtë komunë kanë pasur një trend konstant.

Figura 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010-2013



Komuna e Malishevës planifikon një rritje të lehtë të buxhetit në vitet e ardhshme dhe kjo do të financohet nga rritja e të hyrave komunale dhe grantit qeveritar. Pjesa më e madhe e buxhetit do të shpenzohet në sektorin e arsimit dhe ky sektor do të ketë edhe rritje me buxhet rreth 74 mijë euro.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

	2014	2015	2016
Të hyrat totale	10.577.123	10.668.000	10.735.900
Të hyrat vetanake	787.500	795.000	900.000
Grantet	9.789.623	9.873.000	9.835.900
Shpenzimet totale	10.577.123	10.668.000	10.735.900
Sektori i Përgjithshëm	3.686.895	3.700.000	3.750.000
Sektori i Arsimit	5.681.675	5.750.000	5.755.900
Sektori i Shëndetësisë	1.208.553	1.218.000.00	1.230.000

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Malishevës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.